

Zgjerimi i qasjes në sigurimin shëndetësor për të gjithë (përfshirë emigrantët që nuk janë të dokumentuar!)

Duke filluar nga ky nëntor, kushdo që jeton në shtetin e Washington do të ketë mundësinë të blenë sigurimin shëndetësor dhe dentar nëpërmjet *Washington Healthplanfinder*, pavarësisht nga statusi i imigrimit.

Regjistrohu deri më 15 dhjetor për sigurimin shëndetësor që fillon më 1 janar 2024.



Kualifikimi, statusi i imigrimit dhe siguria

Termet kryesorë

Kësti: Secili anëtar paguan një tarifë mujore të quajtur këst. Çmimi i këstit tuaj varet nga plani juaj i sigurimit shëndetësor.



I zbritshëm: Sigurimi juaj shëndetësor fillon të ndihmojë për të paguar faturat tuaja pasi të "paguani shumën tuaj zbritëse". Të gjitha planet paguajnë për kujdesin parandalues përpara se të paguhet shuma juaj zbritëse. Planet e Cascade Care paguajnë më shumë shërbime përpara se të paguhet shuma juaj zbritëse. Këto shërbime përfshijnë:



Kujdesin parandalues



Vizitën e mjekut të kujdesit parësor për trajtimin e sëmundjes ose lëndimit



Shërbimet e shëndetit mendor



Recetat e përgjithshme



Kujdesin urgjent, kur keni nevojë për kujdes menjëherë, por nuk keni urgjencë siç është sulmi në zemër.

Bashkëpagesa dhe bashkë sigurimi: Këto janë shpenzimet që do të paguani kur të shkoni te mjeku. Bashkëpagesa juaj është një shumë fikse (\$1-\$50). Bashkë sigurimi juaj është përqindje e kostos së shërbimit. Planin juaj i sigurimit shëndetësor paguan për pjesën tjetër të vizitës suaj.

Kush është i pranueshëm?

Nëse jetoni në shtetin Washington, mund të blini sigurim shëndetësor nëpërmjet *Washington Healthplanfinder*, edhe nëse jeni një imigrant i pa dokumentuar. Ju nuk keni nevojë për shtetësi amerikane, një kartë të gjelbër ose dokumente të tjera imigracioni.

A do të ndikojë marrja e sigurimit shëndetësor në statusin tim të imigrimit ose kërkesën për shtetësi?

Marrja e sigurimit shëndetësor nuk ndikon në statusin e imigrimit ose aplikacionet për shtetësi për ju, familjen tuaj ose këdo që jeton me ju.

A do të më bëjë marrja e sigurimit shëndetësor "barrë publike"?

Aplikimi ose marrja e sigurimit shëndetësor, dhe marrja e ndihmës financiare për të paguar sigurimin, nuk të bënë "barrë publike". Kjo do të thotë që nuk do të ndikon në statusin e imigrimit ose aplikacionet për shtetësi për ju, familjen tuaj ose këdo që jeton me ju.

Unë jam i pa dokumentuar. A është informacioni im i sigurt?

Siguria juaj është e rëndësishme për ne. Informacioni juaj nuk do të përdoret për detyrim të imigracionit. Ligjet federale dhe shtetërore mbrojnë privatësinë e njerëzve që aplikojnë për sigurim shëndetësor nëpërmjet *Washington Healthplanfinder*. Informacioni në lidhje me statusin e imigracionit do të përdoret vetëm për të përcaktuar nëse kualifikoheni për mbulim dhe jo për detyrim të imigracionit.

Pyetjet e bëra shpesh



Regjistrimi

Çka është "regjistrimi"

Ju regjistroheni për sigurim shëndetësor duke zgjedhur një plan shëndetësor nëpërmjet *Washington Healthplanfinder*, pastaj do të paguani për planin tuaj shëndetësor.

Kur mund të regjistrohem?

Çfarë është "regjistrimi i hapur"?

Çdokush mund të regjistrohet për sigurim shëndetësor në *Washington Healthplanfinder* ndërmjet **1 nëntorit dhe 15 janarit**. Kjo periudhë quhet **regjistrim i hapur**. Regjistrimi i hapur ndodh çdo vit.

Çka do të ndodh nëse humbas regjistrimin e hapur? Çfarë është "regjistrimi special"?

Disa njerëz mund të regjistrohen në kohë të tjera. Ky quhet **regjistrim special**. Nëse keni ndryshime në jetë (humbje pune, ndryshim në statusin martesor, lindje e një fëmije, etj.) ose jeni person me të ardhura të ulëta, jo mund të regjistroheni jashtë periudhës për regjistrim të hapur.

Çfarë do të më duhet për t'u regjistruar?

Washington Healthplanfinder do të kërkojë informacion për ju dhe familjen tuaj për të përcaktuar nëse kualifikoheni për mbulim.

Sa kohë do të duhet për këtë?

Aplikimi mund të zgjasë rreth 1 orë.

Ku mund të gjej ndihmë për t'u regjistruar? A ofrohet ndihmë në gjuhë të tjera?

E gjithë asistenca për regjistrim është **falas***. Më poshtë janë tri mënyra për të marrë ndihmë:



Telefononi

1-855-923-4633

TTY/TDD: 1-855-627-9604

Ndihma është në dispozicion në mbi 200 gjuhë.



Lidhuni

Caktoni një takim me një udhëzues shëndetësor, ndërmjetës ose burim të besuar në komunitetin tuaj.



Vizitoni

wahealthplanfinder.org



ose skanoni kodin QR me kamerën tuaj



Për të parë paraprakisht planet në zonën tuaj, vizitoni **wahealthplanfinder.org**. Përdorni veglën "Shfleto dhe krahaso planet (Browse and Compare Plans)".

*Nëse nuk e dini që dikush është i certifikuar për t'ju ndihmuar, ose nëse ju kërkojnë t'i paguani për shërbimin e tyre, telefononi qendrës për mbështetje të klientit (Customer Support Center) të *Washington Healthplanfinder* në numrin 1-955-WAFINDER.



Pyetjet e bëra shpesh



Kostoja e sigurimit shëndetësor

Sa kushton sigurimi shëndetësor?

Kostoja e blerjes së sigurimit shëndetësor varet nga gjëra të tilla si të ardhurat tuaja, madhësia e familjes dhe vendi ku jetoni.

Shfletoni dhe krahasoni planet në wahealthplanfinder.org ose punoni me një burim të besuar në komunitetin tuaj për të mësuar se sa do t'ju kushtonte një plan.

Çfarë kuptimi kanë këto fjalë: këst, i zbritshëm, bashkë sigurim, bashkëpagesë?


Kësti: Secili anëtar paguan një tarifë mujore të quajtur këst. Çmimi i këstit tuaj varet nga plani juaj i sigurimit shëndetësor.

I zbritshëm: Sigurimi juaj shëndetësor fillon të ndihmojë për të paguar faturat tuaja pasi të "paguani shumën tuaj zbritëse". Të gjitha planet paguajnë për gjëra të caktuara, si janë kontrollet shëndetësore, përpara se të paguhet shuma zbritëse.

Bashkëpagesa dhe bashkë sigurimi: Këto janë shpenzimet që do të paguani kur të shkoni te mjeku. Bashkëpagesa juaj është një shumë fikse (\$1-\$50). Bashkë sigurimi juaj është përqindje e kostos së shërbimit. Plani juaj i sigurimit shëndetësor paguan për pjesën tjetër të vizitës.

Çfarë janë shpenzimet "direkte – nga xhepi"?

Shpenzimet nga xhepi (të zbritshmit, bashkë pagesat dhe bashkë sigurimi) i referohen shumës që paguani kur shkoni te mjeku.



Zgjedhja e planit

Cilat plane të sigurimit shëndetësor janë në dispozicion?

Janë tri nivele të planeve të sigurimit shëndetësor në dispozicion nëpërmjet *Washington Healthplanfinder*. Bronz, Argjend dhe Ar. Shuma që paguan kompania juaj e sigurimit shëndetësor varet nga niveli që zgjidhni. Mesatarisht, plani Bronz paguan rreth 60%, plani Argjend paguan rreth 70%, dhe plani Ar paguan rreth 80% të faturave tuaja mjekësore.

Bronz: Këto plane kushtojnë më pak në muaj, por paguajnë më pak për shpenzimet kur keni nevojë për kujdes.

Argjend: Këto plane mbulojnë më shumë shpenzime kur keni nevojë për kujdes, por mund të kushtojnë më shumë. Nëse kualifikoheni për kursime Cascade Care këto plane mund të kushtojnë më pak se planet Bronz.

Ar: Këto plane kushtojnë më shumë në muaj, por paguajnë më shumë për shpenzimet kur keni nevojë për kujdes. Nëse kualifikoheni për kursime Cascade Care dhe keni nevoja të konsiderueshme për kujdes shëndetësorë këto plane mund të jenë të përshtatshme.

A do të më ofrohen mjekë më të mirë nëse zgjedh planin Argjend ose Ar?

Jo. Cilësia e kujdesit është e njëjtë për të gjitha planet.

